



Republika e Kosovës
/Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
/Ministrastvo Kulture, Omladine i Sporta/Ministry of Culture, Youth and Sports

Ministri/Ministar/Minister

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BRËNDËSHEM TË MKRS

Numër:03/2010

Datë:14.05.2010

Në mbështetje të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1 paragrafi 1.3 pika (ç) të Rregullorës nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit, me qëllim të organizimit funksional, dhe të ndarjës së punëve dhe përgjegjësi në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit z.Lutfi Haziri me datë 14.05.2010, nxjerrë këtë Rregullore:

Neni 1

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit organizohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Rregullorën në fuqi mbi Degën e Ekzekutivit.

Neni 2

Gjatë ushtrimit të detyrës, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit nxjerr rregullore, udhëzime administrative, vendime si dhe akte të tjera nenligjore, me qëllim që të rregulloj punën e Ministrisë në përgjithësi apo në fusha të veçanta.

Neni 3

Në ushtrimin e detyrës së tij, Ministri ndihmohet nga Zëvendësministri si dhe nga këshilltarët politik, në përputhje me legjislacionin ekzistues në fuqi.

Neni 4

Kabineti i Ministrit

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të përkrahet nga Kabineti Ministror, i përberë në përputhje me ligjin përkatës për Qeverinë, duke përfshirë edhe plotësimin e të gjitha normave protokolare.

Neni 5

Struktura e Kabinetit të Ministrit

Struktura e Kabinetit të Ministrit përbehet prej :

1.Ministrit

2.Zëvendësministrit

3.Këshilltarët Politik dhe Profesional

3.1.Këshilltari për Trashëgimi Kulturore

3.2.Këshilltari për Muzikë dhe Vallëzim,

3.3.Këshilltari për Teater dhe Kinematografi ,

3.4.Këshilltari për Art,

3.5.Këshilltari për Rini dhe Integritime Evropiane,

3.6.Këshilltari për Sport.

3.7.Këshilltarë tjerë profesional.

4.Shefi i Kabinetit (Udhëheqës i Shërbimit Protokolar)

5.Ministri do të përkrahet edhe nga Këshillat e Politikave të MKRS :

5.1 Këshilli për Trashëgiminë Kulturore,

5.2 Këshilli për Artin,

5.3.Këshilli për Librin,

5.4.Këshilli për Teatrin,

5.5.Këshilli për Kinematografinë,

5.6 Këshilli për Muzikën dhe Vallëzimin ,

5.7.Këshilli për Industrinë kreative,

5.8 Këshilli për Muzeun dhe Galerinë,

5.9.Këshilli për Rininë dhe Sportin.

Këshillat e lartpërmendura në pikën 5 ofrojnë dhënien e këshillave Ministrit për dokumentet strategjike të Ministrisë, përkatësisht në orientimet strategjike, politikat e MKRS-së, programet dhe projektet, planin e veprimit dhe organigramin e MKRS-së.

Neni 6

Zyra e Sekretarit të Përherëshëm

Sekretari i Përherëshëm ka këto përgjegjësi:

- Administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të ministrisë dhe për sigurimin e zbatimit të funksionit që i është besuar;
- Ofrimin e analizave të sakta dhe të shpejta për Ministrin;
- Ofron mbështetje analitike dhe logjistike për Ministrin dhe Ministrinë;
- Siguron mbikëqyrjen adekuate;
- Dhënien e këshillave të paanshme profesionale dhe të sakta për autoritetet përkatëse;
- Organizimin dhe punësimin e personelit;
- Nxjerrjen e urdhëresave administrative dhe vendimeve për çështjet të funksioneve përkatëse;
- Menaxhimin efektiv dhe efikas të burimeve të resorit përkatës, zbatimin e politikës jo-diskriminuese për personelin përkatës, duke përfshirë edhe përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet,

- Sigurimin e përbërjes së personelit që reflekton karakterin shumetnik të Kosovës;
- Punësimin e personelit në bazë të kualifikimit profesional, aftësive dhe meritave, përmes konkursit të hapur dhe të drejtë;
- Sekretari i Përherëshëm cakton një zyrtar të autorizuar financiar për ministrinë e tij/saj dhe siguron harmoni të plotë me vendimet, urdhëresat administrative dhe rregullat financiare, që janë nxjerrë përkitazi me këtë çështje nga Ministria për Ekonomi dhe Financa apo nga autoritetet tjera përkatëse.
- Të gjithë Drejtorët e Departamenteve dhe Udhëheqësit e Zyrave i pergjigjen dhe I raportojnë drejtëpërdrejtë për punën e tyre Sekretarit të Përherëshëm.

Zyra e Sekretarit të Përherëshëm do të ketë 3 punonjës. Sekretari i Përherëshëm, do të ketë një asistent/e ekzekutive, një asistent/e administrative dhe një vozitës.

Zyra e Sekretarit të Përherëshëm drejtëpërdrejtë mbikëqyrë dhe administron:

- Zyrën për Integritet Evropian dhe koordinim të zhvillimit,
- Zyrën e Prokurimit,
- Zyrën për të Drejta të Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Përafërta,
- Zyrën për Informim Publik,
- Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore,
- Njësinë e Auditimit të Brëndëshëm,
- Zyrtarin Çertifikues.

Neni 7

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këto Departamente :

1. Departamenti i Kulturës,
2. Departamenti i Trashëgimisë Kulturore,
3. Departamenti i Rinisë,
4. Departamenti i Sportit,
5. Departamenti i Administratës Qëndërore,
6. Departamenti Ligjor.

Neni 8

Departamenti i Kulturës

Departamenti i Kulturës ka këto përgjegjësi:

- Zbaton politikat - programore dhe buxhetore në Departamentin e Kulturës, në bashkëpunim me të gjithë Divizionet e Departamentit, si dhe me Institucionet e Trashëgimisë Kulturore që i mbështet ky Departament,
- Zbaton politika zhvillimore në fushën e kulturës duke përfshirë divizionet përkatëse sipas standardeve evropiane,
- Duke konsideruar kulturën si një mekanizëm me ndikim të fuqishëm për zhvillimin demokratik të vendit, si dhe për ri-afirmimin e identitetit kulturor të Kosovës në rajon si pjesë përbërëse e identitetit kulturor evropian,
- Mbështet, koordinon dhe ndjek ecurinë e zbatimit të projekteve kulturore dhe

artistike të ideuara nga divizionet dhe sektorët profesional të saj, në të mirë të intensifikimit, promovimit dhe njohjes së vlerave më përfaqësues të artit dhe kulturës së shkruar të Kosovës, me vendet dhe kulturat e përparuara evropiane dhe botërore nëpërmjet divizioneve dhe sektorëve të saja monitoron drejtpërdrejt veprimtarinë kulturore dhe artistike të institucioneve në varësi të MKRS-ës, si produkt i politikave të saj kulturore zhvillimore dhe integruese,

- Në bashkëpunim me strukturat homologe të vendeve të tjera, ndikon drejtpërdrejt në ndërtimin e programeve të përbashkëta në fushen e Divizioneve me qëllim të koordinimit të mëtejshëm të politikave për integrimin e kulturës së Kosovës në hapësirat ndërkombëtare,
- Në bashkëpunim me divizionet e saja, në vazhdimësi përgatit akte nënligjore së bashku me Departamentin Ligjor në zbatim të ligjeve në fuqi, si dhe përcjellë reformat ligjore kohore, nxitë dhe motivon krijimtarinë artistike të brezit të ri për përfshirjen e tyre në jetën artistike kulturore.

Departamenti i Kulturës i ofron mjedisit mbështetjen për nxitjen dhe fuqizimin e vlerave të kulturës, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar edhe karakterin multietnik në kuader të proceseve integruese të Kosovës.

Në kuadër të Departamentit të Kulturës janë: Divizioni i Artit, Divizioni i Librit, Divizioni i Teatrit, Divizioni i Kinematografisë, Divizioni i Muzikës dhe Vallëzimit, Divizioni i Muzeve dhe Galerive, Divizioni i Industrisë Kreative, Divizioni i Diversitetit dhe Promovimit Kulturor.

Departamenti përgaditë :

- strategjitë e realizimit të plan- programeve,
- Marrin pjesë në planifikimin dhe përcaktimin e politikave programore dhe Buxhetore në Departamentin e Kulturës dhe të MKRS-së,
- përcaktojnë punët dhe detyrat me prioritet në Divizionet e Departamentit, sipas politikave programore të aprovuara,
- zhvillojnë strategjinë për përkrahjen e institucioneve dhe grupeve të tjera artistike si dhe përmes
- projekteve ndihmojnë materialisht grupet folklorike, krijuese e individuale dhe të OJQ-ve, zhvillojnë strategjinë e promovimit e të bashkëpunimit me artistët e pavarur, dhe me institucionet relevante përfshirë aktivitetet teatrore, muzikore, vallëzuese dhe ekspozitat e ndryshme brenda dhe jashtë shtetit,
- Drejtori i DK-së koordinon angazhimet e divizioneve me institucionet e kulturës, dhe me sektorët tjera në Ministrinë e Kulturës dhe jashtë saj,
- Drejtori i Departamentit të Kulturës për punën e vet të menaxhimit raporton te Sekretar Përhershëm i MKRS-së.

Neni 9

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore ka këto përgjegjësi :

- Zbaton politikat - programore dhe buxhetore në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me të gjithë Divizionet e Departamentit, si dhe me Institucionet e Trashëgimisë Kulturore që i mbështet ky Departament;
- mbikëqyrë dhe u jep udhëzime të punës zyrtarëve të Divizioneve dhe punëtorëve tjerë të Departamentit, në interes të mbarëvajtjes së punës në Departament;

- Mbikëqyrë punën dhe aktivitetin e gjithëmbarshtëm të planit akcional të politikave programore dhe programeve të MKRS,
- Ndhmon të gjithë zyrtarët e sektorëve që të hartojnë strategjinë e zhvillimit për realizimin e plan- programeve të sektorëve dhe Institucioneve në kuadër të Departamentit;
- Mbikëqyrë dhe koordinimi inventarizimin e gjithëmbarshtëm të TKK-së duke përfshirë këtu edhe vendosjen në Programin e shenimeve në nivel kombëtar.
- Merr pjesë në planifikimin dhe përcaktimin e politikave programore dhe buxhetore të MKRS-së, përcakton punët dhe detyrat me prioritet në sektorët e Departamentit, sipas politikave programore ,
- Zhvillon strategjinë e promovimit të Trashëgimisë Kulturore në bashkëpunim me Institucionet e Trashëgimisë Kulturore dhe me OJQ-të;
- Departamenti i Trashëgimisë Kulturore përbëhet prej këtyre divizioneve : Divizioni i Trashëgimisë Arkeologjike, Divizioni i Trashëgimisë Arkitekturore, Divizioni i Trashëgimisë së Luajtëshme , Divizioni i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Divizioni i Menaxhimit të Integruar të TK dhe Pejsazhet Kulturore.
- Koordinimi dhe mbikqyerja e përgjithshme e rrjetit territorial të konservimit dhe restaurimit si dhe mbrojtjes ligjore,
- Aktiviteteve aktuale të bëra nga rrjeti territorial,
- Menaxhimi i bazës së të dhënave të inventarit për TKK-në,
- Në përcaktimin e Institucioneve përzgjedhë objekteve për mbrojtje të përkohshme si TKK

Mbrojtja dhe masat ligjore

- Vlerësimi i pronave (aseteve) të propozuara për mbrojtje të përhershme,

DTK nepërmjet inspektorateve rajonale dhe IKRK dhe Institucioneve të tjera të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës sipas Ligjit, mbikëqyrë konservimin dhe restaurimin e duhur të trashëgimisë kulturore. Pikat e funksionimit dhe përgjegjësi si më poshtë do të përcaktohen me udhëzim të veçantë administrativ:

- Dhënia e lejes me shkrim për cilindo intervenim në trashëgiminë kulturore,
- Urdhër ndalimi i punëve të pa autorizuara në trashëgiminë kulturore,
- Zbatimi dhe kontrolli e aktiviteteve të konservimit dhe restaurimit ,
- Dhënia e lejes (autorizimit) me shkrim për projektet e restaurimit dhe konservimit,
- Mbikëqyerja e mbajtjes së procesit të intervenimeve të konservimit dhe restaurimit ,
- Urdhër për ndaljen e punëve të konservimit dhe restaurimit në rast të pa rregullsive përcaktimi i perimetrit të monumenteve,
- përcaktimi i rrethës së zonës së mbrojtur duke iu referuar planit hapësinor nën nenin. 2 të Ligjit për Planifikim Hapësinor,
- Bashkëpunim me autoritete te nivelit qendror dhe lokal të përcaktohen politikat për ruajtje, menaxhim dhe përmirësim të zonave të konservimit arkitektural ,

- Dhënia e lejes me shkrim për projekte të ndryshimit, shkatërrimit, konservimit dhe restaurimit të monumenteve arkitekturale,
- Dhënia e lejes me shkrim për projekte për ndryshim, shkatërrim, konservim dhe restaurim të rrethojave të jashtme të ndërtesave dhe tërësisë së hapësirave të konservuara arkitekturale,
- Vlerësimi i aplikacioneve për lejet e ndërtimit të ndërtesave apo zhvillimet tjera në zonat e mbrojtura, zonat e konservuara arkitekturale,
- Dhënia e lejes me shkrim për vendosjen e reklamave,
- Zbatimi i intervenimeve të riparimit urgjent pavarësisht nga pronari ,
- Dhënia e lejes me shkrim për shfrytëzim ekonomik dhe kulturor të trashëgimisë arkitekturale,
- Vlerësimi i aplikacioneve të dorëzuara nga autoritetet lokale të planifikimit dhe ndërtimit për ndërtimin e ndërtesave ose zhvillimeve tjera në trashëgiminë e njohur arkeologjike,
- Njoftimi i aplikuesit për mundësinë e dhënies së lejes,
- Pranimi i njoftimit të zbulimeve të rastësishme arkeologjike dhe vendimi për ndaljen e mundshme të punës ,
- Aprovimi i shpërblimit financiar për gjetjet arkeologjike,
- Pranimi i njoftimit zbulimet e aksidenteve arkeologjike,

Rezervatet Arkeologjike

- Përkufizimi i rezervave arkeologjike për t'u klasifikuar si zona të veçanta në Ligjin për Planifikim Hapësinor,
- Përcaktim i rezervave arkeologjike për t'u futur nën mbrojtje bazuar në inventaritet,
- Zbatimi i masave të shpëtimit arkeologjik,
- Dhënia e lejes me shkrim për aktivitete të cilat mund të shkaktojnë dëmtime në rezervat arkeologjike,

Zonat dhe hapësirat e mbrojtura

- Përkufizimi i zonës së mbrojtur përreth monumenteve duke iu referuar planit hapësinor nën nenin 2 të Ligjit për Planifikim Hapësinor ,
- Vlerësimi i aplikacioneve për lejimin e ndërtimit të ndërtesave apo zhvillimeve të tjera në zonën e mbrojtur, zonave të konservuara arkitekturale,
- dhënia e lejes me shkrim për aktivitete bujqësore brenda zonës së mbrojtur

Procedura për Gërmimet Arkeologjike

- Dhënia e lejes me shkrim për gërmime arkeologjike,
- Pranimi i raporteve të gërmimit,

Të drejtat dhe obligimet

- Vlerësimi i kompensimit për humbjen e shfrytëzimit të tokës bujqësore apo pronave të tjera,

Këshillat profesionale dhe udhëzimet

- Dispozitat administrative dhe këshillat procedurale,

Trashëgimia e lëvizshme

- Procedurat për vlerësimin e trashëgimisë së lëvizshme ,
- Koleksionet publike,
- *Përcakton Muzeun si Institucion Kompetent për menaxhimin e koleksioneve publike*
- Dhënia e lejes me shkrim për transportimin e trashëgimisë së lëvizshme nga konteksti natyror,
- Masat konservuese të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë së lëvizshme kulturor zbatimi i masave të konservimit, mbrojtjes dhe ruajtjes,

Koleksionet private

- Pranimi i raporteve sa i përket dëmtimeve, humbjeve, shkatërrimeve apo vjedhja e trashëgimisë së lëvizshme ,
- Zbatimi i masave të domosdoshme të sigurisë dhe preservimit në rast të neglizhencës nga ana e pronarit,

Qarkullimi i trashëgimisë së lëvizshme

- Pranimi i trashëgimisë së lëvizshme të konfiskuar,

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore mbikqyrë punën e Inspektorateve për ruajtjen dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në përberje të Qëndrave Rajonale:

1. Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Monumenteve Pejë
2. Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Monumenteve Prishtinë
3. Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Monumenteve Prizren
4. Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Monumenteve Mitrovicë
5. Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Monumenteve Gjilan
6. Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Monumenteve Gjakovë
7. Inspektorati për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Monumenteve Ferizaj

Neni 10

Institucionet Kulturore Kombëtare

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këto Institucione Kulturore Kombëtare, të cilat funksionojnë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
Relacioni administrativ praktik do të përcaktohet me një udhëzim administrativ të veçantë.
Institucionet Kulturore Kombëtare janë:

1. Muzeu i Kosovës dhe rrjeti i tij,
2. Teatri Kombëtar i Kosovës,
3. Instituti i Kosovës për Konservim dhe Restaurim dhe rrjeti i tij,
4. Instituti Arkeologjik i Kosovës,
5. Filharmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës,
6. Biblioteka Kombëtare e Kosovës,
7. Ansambli i Valleve dhe këngëve “Shota”,
8. Galeria e Arteve të Kosovës ,
9. Qendra Kinematografike e Kosovës ,
10. Kosova filmi.

Neni 11

Rregullimi i brendshëm i këtyre institucioneve, rregullohet me statute dhe rregullore të brendshme të miratuar nga Ministri.

Neni 12

Departamenti i Rinisë

Departamenti i Rinisë si mision ka: fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale.

Për të implementuar programin për sektorin e rinisë :

- Zhvillon politikat dhe strategjitë për sektorin e rinisë
- Përfshinë identifikimin e grupeve rinore në rrezik.
- Zhvillon programet e adresuara në kërkesat e tyre dhe
- Promovon qendrat, grupet dhe asociacionet rinore.

Departamenti i Rinisë përbëhet nga tri Divizione si;

- Divizioni për Zhvillimin dhe Përkrahjen e Rinisë i cili përbëhet nga sektori për Promovim dhe Edukim dhe Edukim Joformal dhe Vetëpunësim,
- Divizionit për Zhvillimin e Politikave Integruese i cili përbëhet nga sektori për Politika Rinore dhe për Informim dhe Rrjetëzim,
- Divizionit për Mbrojtjen dhe Integrimin e Rinisë i cili përbëhet nga sektori për Edukim Shëndetësor dhe Integrim Social dhe Rreziqet.

Neni 13

Departamenti i Sportit

Misioni i Departamentit të Sportit në MKRS është avansimi dhe subvencionimi i Sportit dhe Infrastrukturës sportive, në kuadër të Departamentit të Sportit janë 4 Divizione: Divizioni për Federatat Sportive dhe KOK-un, Divizioni për Infrastrukturë Sportive, Divizioni i Sportit Shkollor dhe Divizioni për Ndërkombëtarizimin e Sportit.

Qëllimi i Departamentit të Sportit është që të masivizojë sportin nëpërmjet sportit shkollorë, avansimin e sportit cilësorë, ndërkombëtarizimin e sportit , ngritjen e Infrastrukturës sportive dhe rekuizitave sportive për Palestra sportive dhe Stadiume, sportin femërorë, zhvillimin e sportit multi-etnik, zhvillimi i kapaciteteve menagjuese nëpër federata sportive.

Departamentit i Sportit në MKRS raporton dhe është përgjegjëse direkt tek Sekretari Permanent i MKRS-së:

- për të gjitha aktivitetet sportive nëpërmjet udhëheqësve të Divizioneve të Federatave të sportit dhe Infrastrukturës sportive si dhe sektorëve;
- Zhvillimin dhe planifikimi i politikave dhe programeve për funksionimin e Departamentit të Sportit,
- Vlerësimin profesional i projekteve për subvencionimin e Klubeve, Federatave dhe Reprerentacioneve sportive të cilat marrin pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare,

- Ngritja e kapaciteteve për trajnerë, gjyqtarë dhe administratorë të federatave të sportit.
- Krijimi i mekanizmave dhe programeve për aftësimin e punëtorëve sportiv për hulumtime shkencore sportive,
- Mbështetje financiare reprezentacioneve kombëtare, me prioritet sporteve apo individëve sportiv me rezultate kulmore,
- Pranimi i federatave të sportit në të gjitha asociacionet sportive ndërkombëtare,
- Shkëmbimi i përvojave ndërkombëtare në lëmin e sportit kulmorë,
- Promovimi i sportit në mesin e grupmohave të reja dhe sportin shkollorë;
- Identifikimi dhe përkrahja e talenteve të rinj sportivë,
- Organizimi i Sportit shkollorë dhe federatës së sportit shkollorë,
- Ndërtimi i objekteve të reja sportive, palestrave dhe stadiumeve,
- Rehabilitimi i stadiumeve dhe palestrave sportive të cilat me pak investime i plotësojnë kriteret për zhvillimin garave ndërkombëtare olimpike,
- Bashkëveprimi dhe bashkëfinancimi i MKRS-së me drejtorit komunale dhe donatorë e vendorë dhe ndërkombëtarë për infrastrukturë sportive,
- Plotësimi i kriterëve teknike – infrastrukturave profesionale në bazë të kriterëve të kërkuara nga asociacionet ndërkombëtare,
- Përkrahje materiale klubeve me rezultate kulmore në arenën sportive në bazë të akteve nënligjore të nxjerra nga departamenti i sportit, konform rregulloreve të federatave sportive,
- Mbështetje materiale për reprezentacionet e femrave, me prioritet reprezentacionet e sporteve olimpike që kanë rezultate kulmore,
- Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve për femra trajnere, gjyqtare dhe administratore të sportit,
- Përkrahje në riaktivizimin e klubeve sportive të mëparshme të sportit femëror – me prioritet sportet olimpike,
- Përfshirja e klubeve multi-etnike në institucionet legale dhe të licencuara të sportit të Kosovës,
- Përkrahje me pajisje sportive dhe në infrastrukturë me qëllim të zhvillimit të aftësive menagjuese në aktivitetet sportive dhe institucionet e minoriteteve,
- Promovimi i mëtutjeshëm i qendrës për mjekësi sportive dhe institucioneve tjera referente për mjekësi sportive, ngritja e qendrës antropologjike shkencore në nivel kombëtarë e cila bën hulumtimet kërkimore shkencore e të arriturave në sport,
- Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve profesionale në lëmin e mjekësisë sportive,
- Harmonizimi i kriterëve për kontroll obligative mjekësor sipas standardeve ndërkombëtare të të gjithë sportistëve në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë,
- Departamenti i Sportit në bashkëpunim me Entin e Statistikave për çdo vit grumbullon dhe publikon të dhënat për të gjitha aktivitetet dhe infrastruktura sportive.

Neni 14

Departamenti i Administratës Qëndrore

Departamenti i Administratës Qendrore Ofron shërbimet e nevojshme administrative në lëmin e buxhetit dhe financave për tërë Ministrinë dhe është përgjegjës për:

- Ofrimit të shërbimeve administrative në lëmin e Personelit, për implementimin e Rregullores mbi Shërbimin Civil 2001/36, Urdhëresën administrative 2003/02 dhe Udhëzimet administrative që rregullojnë fushën e Shërbimit Civil të Kosovës,

- Lidhur me trajnimin dhe ofrimin e mundësive për ngritje profesionale të shërbyesve civilë në kuadër të Ministrisë,
- Për hartimin, menaxhimin dhe implementimin e Projekteve sa i përket Departamentit të Administratës Qendrore dhe po ashtu ofron shërbime të nevojshme administrative në këtë sferë edhe për tërë Ministrinë,
- Departamenti i Administratës Qëndrore ka rolin e logjistikës për tërë Ministrinë ku përfshihet akomodimi i Ministrisë, Teknologjia Informativë, Transporti, Arkiva, Përkthimet, Depoja dhe shumë sfera të tjera që kanë rol mbështetës për Ministrinë,
- Shërbimet e nevojshme administrative në lëmin e buxhetit dhe financave për tërë Ministrinë, lidhur me trajnimin dhe ofrimin e mundësive për ngritje profesionale të shërbyesve civilë në kuadër të Ministrisë, për hartimin, menaxhimin dhe implementimin e Projekteve sa i përket Departamentit të Administratës Qendrore dhe po ashtu ofron shërbime të nevojshme administrative në këtë sferë edhe për tërë Ministrinë.

Departamenti i Administratës Qëndrore perbehet nga tri Divizione.

Neni 15

Departamenti Ligjor

Departamenti Ligjor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këto përgjegjësi për:

- Hartimin e politikave dhe të strategjive legjislative në bashkëpunim të ngushtë me Kabinetin e Ministrit, me Departamentet dhe me njësitë e tjera organizative të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar në bashkëpunim të ngushtë me Kabinetin e Ministrit me Departamentet dhe njësitë tjera organizative nga fushëveprimtaria e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sigurimin e përputhshmërisë së ligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore të propozuara/sponzoruar nga ministria me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*Acqius Cummunitarie*), si dhe me ligjet e aplikueshme në Kosovë,
- Dhënien e këshillave ligjore, rekomandimeve, udhëzimeve dhe opinioneve të kërkuara njësisë dhe zyrtarëve brenda ministrisë, Përfaqësimin e ministrisë në Gjykatë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe për asistimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore në favor të Ministrisë,
- Sigurimin e përmbushjes së detyrave ligjore në zbatimin e ligjit dhe të dispozitave tjera nga fushëveprimtaria e Ministrisë,
- Bashkëpunim me institucione të tjera të nivelit qendror dhe lokal për krijimin e infrastrukturës ligjore nga fushëveprimtaria e Ministrisë,
- Hartimin e vendimeve, propozimeve dhe të materialeve të ndryshme të kërkuara nga Sekretari dhe Ministri.

Departamenti Ligjor Udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit dhe përbëhet nga dy Divizione:

- Divizioni për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe
- Divizioni për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të mbështetjes ligjore dhe të bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e legjislacionit.

Neni 16

Organizimi i brëndëshem dhe funksionimi detal i Departamenteve të MKRS, duke përfshirë edhe përshkrimin e vendeve të punës së personelit do të përcaktohet me udhëzime të veqanta administrative.

Neni 17

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këto Zyra dhe Njësi Organizative:

- 1.Zyra për Integritime Evropiane dhe koordinim të zhvillimit,
- 2.Zyra e Prokurimit,
- 3.Zyra për të Drejta të Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta,
- 4.Zyra për Informim Publik,
- 5.Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore,
- 6.Njësia e Auditimit të Brëndëshem,
- 7.Zyrtarin Çertifikues.

Neni 18

Institucionet Kulturore Kombëtare

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këto Institucione Kulturore Kombëtare:

- 1.Muzeu i Kosovës dhe rrjeti i tij,
- 2.Teatri Kombëtar i Kosovës,
- 3.Instituti i Kosovës për Konservim dhe Restaurim dhe rrjeti i tij,
- 4.Instituti Arkeologjik i Kosovës,
- 5.Filharmonia,Opera dhe Baleti i Kosovës,
- 6.Biblioteka Kombëtare e Kosovës,
- 7.Ansambli i Valleve dhe këngëve “Shota”,
- 8.Galeria e Arteve të Kosovës ,
- 9.Qendra Kinematografike e Kosovës ,
- 10.Kosova filmi.

Neni 19

Zyra për Integritime Evropiane dhe kordinim të Zhvillimit

Bazuar në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian, miratuar nga Qeveria e Kosovës,në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe duke filluar nga janari 2006 funksionon Zyra për Integritime Evropiane. Zyra për Integritime Evropiane i përgjigjet drejtë për së drejti autoritetit të Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe asiston kabinetin e Ministrit në përgaditjen e dokumenteve të nevojshme në procesin e integritimeve evropiane dhe koordinimin e donatorëve.

Zyra për Integritime Evropiane dhe koordinim të zhvillimit është përgjegjëse për:

- Bashkërendon punën dhe monitoron zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian dhe bënë përgatitjen e raporteve periodike për arritjen e rezultateve të departamenteve dhe angazhimeve të ndërmarra prej tyre, në kuadër të Dialogut të

Procesit të Stabilizim-Asociimit për pjesën e përgjegjësive që ka Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

- Bashkërendon, monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Europian, të dala nga takimet e përbashkëta me Bashkimin Europian, në nivele të ndryshme; (takimet e rregullta të DPSA),
- Përgatitë mekanizmat metodologjik në funksion të lehtësimit të zbatimit të reformave sektorale, që rrjedhin nga takimet e DPSA-së;
- Bashkërendon, monitoron dhe analizon ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, duke mbajtur lidhje të rregullta institucionale me Departamentet, Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore;
- Vlerëson në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të MKRS përputhshmërinë e projektakteve normative të propozuara nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore me të drejtën e Bashkimit Europian, të cilat duhet të pasqyrojnë në relacionin shoqëruar, shkallën e përafrimit dhe referencat mbi legjislacionin përkatës dhe jurisprudencën e Komunitetit Europian;
- Konfirmon përkthimin e dokumentacionit bazë, të nevojshëm për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian;
- Bashkërendon, programon dhe monitoron ndihmën komunitare dhe donacionet për Kosovën (Programi CARDS, IPA, Programi i Fqinjësisë, TAIEK, si dhe programe të tjera ndihme ku institucionet e Kosovës kanë qasje), në kuadër të procesit të integritit evropian, në fushat që mbulon Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Merr pjesë në veprimtarinë e grupeve të punës, të ngritura nga institucione të tjera qeveritare, për hartimin e programeve të ndryshme për integrimin e Kosovës në Bashkimin Europian;
- Shkëmben të dhëna dhe organizon takime periodike, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, në funksion të procesit të integritit evropian në fushat që mbulon Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Zyra për Proceset e Integritit Evropian në marrëdhëniet me të tretët:

- Bashkërendon hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut përçështjetintegritit evropian;
- Propozon ngritjen e grupeve teknike të punës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga procesi i integritit evropian;
- Kërkon nga departamentet dhe institucionet kulturore, përgatitjen dhe paraqitjen në afate të caktuara të raporteve dhe dokumenteve, në funksion të procesit të integritit evropian;
- Njofton organet përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Europian për përafrimin e akteve normative vendase me të drejtën e Bashkimit Europian dhe për kapacitetet zbatuese të legjislacionit;
- Përgatitë dhe paraqet raporte periodike për procesin e integritit evropian në Ministrinë e Integritit Evropian Strukturën organizative, mandatin dhe detyrat ditore Zyra i përshtatë në koordinim të plotë me Ministrinë e Integritit, Ministrinë e linjës me përgjegjësi të përbashkëta në sektor të caktuar dhe brenda mandatit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit duke e përcjellur në hap avancimin e Republikës së Kosovës në procesin e Integritit Evropian.

Neni 20

Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit është përgjegjëse për :

- Planifikimin, drejtimin dhe menaxhimin e aktiviteteve qendrore të prokurimit në MKRS nën autorizimin e Sekretarit Permanent të MKRS-së dhe në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e ligjit të prokurimit publik në fuqi, rregulloret e prokurimit publik, udhëzimet administrative si dhe çdo akt tjetër nën-ligjor që nxirret, aprovohet dhe lëshohet në zbatim nga institucionet dhe organizmat përgjegjëse për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës,
- Zhvillimin, rishikimin dhe aprovimin e procedurave të reja apo të përmirësuara administrative, blerjen e përditshme si dhe procedurat tenderuese sipas procedurave dhe metodave të përcaktuara me dispozitat e ligjit të prokurimit publik gjithmon duke rrespektuar operim sa më ekonomik dhe efikas të parasë publike,
- Krijimin e përgjigjeve për korrespondencat që kanë të bëjnë me çështje të prokurimit dhe marrjen me detyra dhe probleme të veqanta sikurse përgjigjet në pyetjet e operatorëve të interesuar ekonomik, qytetarëve dhe ankesave eventuale lidhur me ndonjë aktivitet të caktuar të prokurimit gjithmon në pajtueshmëri me dispozitat ligjore,
- Vendosjen e prioriteteve, caktimin e detyrave të punës dhe rishikimin e detyrave më të vështira dhe komplekse,
- Përcjelljen dhe zhvillimin e regjimit të Prokurimit Publik brenda Sektorit Publik,
- Marrjen e iniciativave për forcimin e procedurave të prokurimit në bërjen e tyre më efektive, demonstrimin e përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar operimet në Zyren e Prokurimit dhe proceset e racionalizimit të punës, dhe në bashkëpunim dhe koordinim me zyrat e përgjegjës të ofroj shërbim dhe kualitet sa më të përsosur për komponentët dhe stafin e MKRS-së.

Neni 21

Zyra për të Drejta të Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta

Zyra, zhvillon fushëveprimin e vet bazuar në ligjin për Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta dhe Rregulloresë për themelimin të Zyrës dhe është përgjegjëse për:

- Çertifikon asociacionet e autorëve dhe bartësit tjerë të të drejtave, si dhe subjektet tjera ligjore të specializuara në administrimin e të drejtave të autorit të cilat i përmbushin kriteret profesionale të vendosura nga Zyra, konform Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta,
- Anulon çertifikimin nëse asociacioni i autorëve apo subjekti tjetër ligjor i specializuar në administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, më nuk i përmbushin kriteret e përshkruara për kryerjen e aktiviteteve të tilla, konform ligjit,
- Mbikëqyrë aktivitetet e asociacioneve kolektive konform Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta, cakton listën e ndërmjetësve,
- ofron ndihmë administrative ndërmjetësit dhe përkufizon në detaje procedurën e ndërmjetësimit dhe kushtet tjera në pajtim edhe me Ligjin Nr. 03/L-057 për ndërmjetësim,
- Përgatit legjislacion për avancimin e respektimit drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të përafërta,
- Zyra udhëhiqet nga drejtori, i cili është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e Zyrës dhe siguron që funksionet e besuara të zbatohen;
- drejtori i zyrës merr vendime autonome, në funksion të zhvillimit dhe funksionalizimit të veprimtarisë së kësaj Zyre;
- drejtori zgjidhet në bazë të Rregulloreve dhe Procedurave të Shërbimit Civil dhe për punën e tij,
- Drejtori i Zyrës i përgjigjet Ministrin dhe Sekretarit të Përhershëm të MKRS,

- Zyra promovon, informon dhe ndërmerr aktivitete për vetëdijesimin e opinionit të gjerë, autorëve dhe bartësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të përafërta për rëndësinë e këtij Ligji;
- Zyra organizon programe trajnimi, tryeza, debate publike dhe seminare të karakterit vendor dhe ndërkombëtar, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale për zbatimin në praktikë të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Përafërta,
- Zyra bënë mbledhjen e informatave dhe të dhënave për gjendjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të përafërta në nivel të vendit dhe monitoron zbatimin e konventave ndërkombëtare që nënshkruan Republika e Kosovës dhe marrëveshjeve reciproke që i bënë Zyra, dhe harton propozime për plotësim të legjislacionit dhe mekanizmave të zbatimit.

Zyra për Proceset e Integritimit European në marrëdhëniet me të tretët:

Zyra kordinon veprimet dhe bashkëpunon ngusht me Zyret tjera të Qeverisë përgjegjëse për fusha specifike të Pronësisë Intelektuale. Në rend të parë me:

- Zyrën Për Pronësi Industriale dhe Inspektoratin e tregut,
- Zyra kontribuon në themelimin dhe mbarëvajtjen e mekanizmave koordinues të qeverisë dhe Këshillit kombëtarë për Pronësi Intelektuale, pasi të themelohet,
- Koordinon veprimet që dalin nga Strategjia e Qeverisë për pronësi Intelektuale dhe Partneriteti Evropian me Zyrën për Integritime Evropiane dhe Zyrën Ligjore të MKRS dhe institucionet tjera relevante.

Neni 22

Njësia e Auditimit të Brëndëshem

NJAB në kuadër të MKRS –së është themeluar në bazë të Ligjit të auditimit të brendshëm. Njësia për Auditim të Brendshëm kryesisht mbështetet në Ligjin për Auditimin e Brendshëm Nr.03/L- 128 i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 17 Shtator 2009 dhe në Doracakun e Auditimit të Mbrendshëm, lëshuar në vitin 2008 nga MEF –i , përkatësisht nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm.

Njësia për Auditimin e Brendshëm është përgjegjëse për:

- Vlerësimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe aty ku e shef të nevojshme jep rekomandime për funksionim sa më efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm,
- Auditimi i brendshëm është aktivitet i pa varur këshilldhënës dhe i ofrimit të siguris objektive, i përcaktuar (i projektuar) që të shtoi vlerat dhe të përmirësoi funksionimin e organizatës,
- Ai ndihmon menagjmentin në përmbushjen e objektivave të organizatës. Qëllim i auditimit të brendshëm është identifikimi i fushave me rreziqe (risqe), dhe në bazë të identifikimit të atyre rreziqeve ti rekomandohet menagjmentit mënyra për tejkalimin e tyre,
- Njësia për Auditim të Brendshëm kontrollon rrespektimin e politikave programore, të planeve dhe të programeve të punës, si dhe ligjeve dhe rregullave në fuqi.

- NJAB ka obligim që ti mundësoj qasje të plotë dhe të papenguar në këto dokumente Auditorit gjeneral,dhe çdo autoriteti tjetër publik që ka funksion hetues apo kontrollues;
- Përcjell implementimin e rekomandimeve të dhëna nga vetë NJAB dhe Auditori Gjeneral.

Neni 23 **Zyrtari Çertifikues**

Zyrtari Çertifikues është përgjegjës për:

- Pranimin ,kontrollimin,çertifikimin, aprovimin e lëndëve në sistemin free balance,
- Mbylljen e avanseve të projekteve dhe udhëtimeve zyrtare në përputhje me LMFPF dhe Udhëzimet Financiare 01-02 të thesarit MEF,LPP si dhe dispozitat ligjore,
- Raporton për punën e tij te Sekretari i Përherëshem.

Neni 24 **Zyra për Informim Publik**

Misioni i Zyrës për Informim dhe MP, përmbushet përmes informimit korrekt dhe koherent të opinionit publik për punën kulturore, rinore dhe sportive po ashtu me projektet, strategjitë e shërbimet e MKRS-së. Zyra për Informim Publik është përgjegjëse për:

- Monitorimi, arkivimi i materialeve dhe komentet rreth tyre mbesin detyra të përhershme
- Kontakte me gazetarë të gjitha medimeve në ofrimin e informatave për temat aktuale që dalin gjatë javës dhe muajit,
- Grumbullimi dhe hulumtimi i temës që trajtohet në media,
- Detyrë e përhershme e Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun është edhe takimi me zyrtarë të departamenteve që janë të angazhuar për sjelljen e materialeve për web faqe,
- Monitorimi i medieve lidhur me raportimet që i përkasin fushë veprimtarisë së MKRS-së, në veçanti i mesazheve kyçe që dalin nga këto raportime,
- Organizimi i konferencave për medie, Monitorimi dhe mbikëqyrja e shtypit ditor dhe i medimeve elektronike, Fotokopjimi i teksteve, arkivimi dhe vendosja e tyre në foli, Seleksionimi dhe redaktimi i materialeve për veb faqe, Këshillimi i stafit për aktivitetet komunikuese si dhe Arkivimi i xhirimeve të takimeve në MKRS,
- Implementimi i politikave zhvillimore në fushën e informimit, Monitorimi i rezultateve të pasuara në mjetet e Informimit Publik,
- Prezantimi i të arriturave në fushën e informimit,
- Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit,
- Përmbushja e standardeve sipas nivelit të përgjegjësisë së Zyrës për Informim Publik,Fotografimi dhe incizimi i takimeve të Ministrit dhe ngjarjeve tjera të MKRS-së,
- Bashkëpunimi me Zyrat e Informimit me ministritë tjera të Qeverisë së Kosovës dhe të Presidencës,Analizë medieve mbi mënyrën, se , si i pasqyron dhe përçon tek publiku aktivitet e Ministrit dhe të MKRS-së, Sensibilizimi i opinionit për aktivitete vepruese të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në të gjithë sektorët e MKRS-së, Afirmimi i rezultateve të shënuara në sukseset e projekteve të Kulturës,Rinisë dhe Sporteve,
- Në zhvillimin dhe ngritje të vazhdueshme profesionale dhe të shërbimeve të tjera të ofruara për publikun,
- Publikimet në mediumet elektronike: emisione dokumentare për Kulturën dhe Rininë kosovare, e ato Sportive në emisione tematike në TV e tjera kombëtare,Aktivitete tjera në terren, si, organizimi i konferencave,inaugurimeve,promovimeve e shumë ngjarje tjera të natyrës së takimeve me publikun.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun është në kuadër të Zyrës së Sekretarit Permanent dhe Shefi i Zyrës për Informim dhe MP i përgjigjet Sekretarit permanent të MKRS-së.

Neni 25

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore,

Mandati i NJDNJ është që të ndërmerr masa efektive për vlerësimin e pajtueshmërisë së politikave, legjisllacionit dhe aktiviteteve të Ministrisë me standardet relevante ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Detyrat kryesore të NJDNJ janë:

- Të ofroj rekomandime për Sekretarin e Përhershëm dhe zyrtarët tjerë të ministrisë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut,
- Të merr pjesë në hartimin e ligjeve, udhëzimeve administrative, politikave me qëllim që të gjitha të jenë në pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut,
- Të bashkëpunoj ngushtë me Institucionin e Obudsperson-it në Kosovë(IOK) dhe të mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve të Obudsperson-it në ministri,
- Vlerëson nivelin e implementimit të standardeve të drejtave të njeriut brenda ministrisë,
- Merr pjesë aktivisht në grupet punuese ndërministrore,
- Është pjesë përbërëse e grupeve punuese ndërministrore për hartimin e Raporteve për organet referuese të traktateve lidhur me dispozitat ndërkombëtare për të drejta e njeriut që janë të zbatueshme në Kosovë.
- Organet referuese të traktateve janë komitete të përbëra nga ekspert të pavarur,që monitorojnë zbatimin e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe lëshojnë rekomandime për përmirësim të zbatimit nga ana e qeverisë.

Neni 26

Kjo rregullore hyn në fuqi menjherë në momentin e nënshkrimit nga Ministri.



Z.Lutfi Haziri, Ministër